

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË PODUJEVË** : - Departamenti i përgjithshëm – divizioni civil : me gjyqtarin Bujar Muzaqi, dhe procesmbajtësen Mirvete Ahmeti, në çështjen juridiko civile të Paditësve V. dhe G. A. të dytë nga Fshati Sh., Komuna e P. të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Z. I., avokate me seli në P. Rr. “...” .../D P., kundër të Paditurit Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, në çështjen kontestimore kompensim dëmi, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, në prani të përfaqësuesit të autorizuar dhe përfaqësuesve ligjor të paditësve, dhe në prani të përfaqësuesit të autorizuar të të paditurit me datë 16.05.2013 morri këtë :

## **A K T G J Y K I M**

- I. **PJESËRISHT APROVOHET** kërkesëpadia e paditësve V. A., dhe G. A. nga Fshati Sh., Komuna e P., **SI E BAZUAR.**
- II. **DETYROHET** e Paditura Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në P., t’ia paguan Paditësve për aksidentin e dt.10.08.2007 si pasojë e lëndimeve të pësuar dhe atë Paditësit G. A. në emër të kompensimit të dëmit jo material shumë prej 24.800,00 Euro, dhe në emër të kompensimit të dëmit materialë në shumë prej 1.000,00 Euro, Paditësve B. dhe Sh. A. për shkak të dhimbjeve shpirtërore për shkak të invaliditetit të rëndë të djalit të tyre secilit veç e veç shumen prej 2.100,00 Euro, dhe Paditëses V. A. në emër të kompensimit të dëmit jo material shumë prej 7.300,00 Euro, dhe në emër të kompensimit të dëmit materialë në shumë prej 100,00 Euro, e të gjitha këto me kamatë vjetore siç e paguajnë Bankat afariste në Republikën e Kosovës kursimtarëve të vet në mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga data e parashtrimit të padisë dt.23.11.2007 e të gjitha në afatin prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi dhe atë :
  - **Paditësit G. A. në emër të dëmit jomaterial :**
  - Në emër të dhëmbjeve fizike shumë prej 1.700,00 Euro;

- Për frikë të përjetuar shumën prej 1.050,00 Euro;
- Për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 21.000,00 Euro.
- Për shemtim trupor shumën prej 1.050,00 Euro;

**Në emër të dëmit material :**

- Për ushqim të sforcuar shumën prej 400,00 Euro;
- Për rehabilitim mjekësor shumën prej 300,00 Euro;
- Për shpenzime të mjekimit; shumën prej 300,00 Euro

**Paditësve B. dhe Sh. A., prindërve të G. A.:**

- për shkak të dhimbjeve shpirtërore për shkak të invaliditetit të rëndë të djalit të tyre secilit veç e veç shumën prej 2.100,00 Euro.

-

**Paditëses V. A. në emër të dëmit jomaterial :**

- Në emër të dhëmbjeve fizike shumën prej 2.400,00 Euro;
- Për frikë të përjetuar shumën prej 1.400,00 Euro;
- Për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 3.500,00 Euro.

**Në emër të dëmit material :**

- Për ushqim të sforcuar shumën prej 100,00 Euro;

- I. Përtej shumës së gjykuar shuma në lartësi prej 12.682,00 Euro për paditësin G. A. dhe përtej shumës së gjykuar shuma në lartësi prej 700,00 Euro për prindërit e paditësit G. A., B. dhe Sh. A. **REFUZOHEN SI TË PABAZUARA;**
- II. Përtej shumës së gjykuar shuma në lartësi prej 1.140,00 Euro për paditësen V. A. si dhe kërkesa për ndihmën e huaj dhe kërkesa për kompensimin e dëmit për shemtim **REFUZOHEN SI TË PABAZUARA.**
- III. **DETYROHET** e Paditura Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë që paditësve t’ua kompensoi në emër të procedurës kontestimore shumën prej 2.589,00 Euro, të gjitha në afatin prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

**A r s y e t i m**

Paditësit në padi, dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar ndër të tjera kanë deklaruar se me datën 10.08.2007, në magjistralen Podujevë – Prishtinë gjegj. Në Fshatin Sh. nga aksident trafiku Paditësit G. A., dhe Paditësja V. A. kanë pësuar lëndime të rënda trupore, po ashtu ka deklaruar se automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti ka qenë i siguruar te e Paditura.

Në seancen e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 16.05.2013 përfaqësuesi i autorizuar i Paditësve av. Z. I. deklaroi se mbetem në tërësi pranë kërkesëpadiisë si në lëndën paraprake C.nr.325/07 dhe i propozojmë gjykatës që kërkesa padia e precizuar me shkrim dhe në procesverbalin me numër të cekur më lartë të miratohet si e bazuar, me qenëse në ekspertizat plotësuese nuk ka ndryshime nga ekspertizat e kryera në lëndën me numer të cekur më lartë, duke i propozuar Gjykatës që kërkespadiia të miratohet si e bazuar. Po ashtu deklaroi se kërkespadiia e paditësve është e bazuar me 70 % të përgjegjësisë së të paditues dhe 30% të lëshimeve nga ana e paditësve të mitur që do të ishte zbritje maksimale për rastin konkret, por vetëm e vetëm ti shmangemi kontestimeve eventuale edhe sa i përket bazës.

Në seancen e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 16.05.2013 përfaqësuesi i autorizuar i të Paditues K. P. deklaroi se mbetet në tërësi pranë deklarimeve të thëna në seancat e kaluara, ankesës së paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë, ashtu që për paditësin e mitur G. A. ofron shumën prej 21.000,00 €, ndërkaq për paditësen e mitur V. A. ofertën në lartësi prej 5.000,00 €uro. Po ashtu ka deklaruar se në rast se i autorizuari i të miturve përkatësisht edhe përfaqësuesit ligjor janë të pajtimit me ofertat e paditura shpreh vullnetin që kontesti të zgjidhet me marrëveshje gjyqësore.

Në seancen e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 22.02.2013 u administruan provat më të rëndësishme për vërtetimin e plotë dhe të drejt të gjendjes faktike siç janë : raporti i Shërbimit policor me nr.të rastit 07-AR-01334 me shkicën në vendin e ngjarjes , fletëlëshimi me epikrizë për paditësin G. A. me nr.të amzës 360 dt.10.08.2007, fletëlëshimi me epikrizë për paditësin G. A. me nr.të amzës .... dt.15.08.2007, raporti i QKUK-së Prishtinë me nr.të protokollit 29349 dt.10.08.2007 për paditësin G.A., ekspertiza mjekësore për paditësit G. A. dhe Paditëses V. A. e hartuar nga ortopedi Xh. S. e dt.20.07.2008, mendimi i ekspertit – psikiatër F. D. për paditësit G. dhe V. A. si dhe për prindërit e paditësit të mitur G. A., mendimi shtesë dhënë nga eksperti F. D.-neuroopsikiater për paditësin e mitur G. A. dt.02.05.2013, raportet mjekësore, gjegj. Udhëzimet për specialistin, të cilat gjinden në shkresa të lëndes, specifikimi i shpenzimeve materiale të dorëzuar pranë Gjykatës nga përfaqësuesi i autorizuar i paditësve me dt.20.10.2009 së bashku me fletpagesat e bashkangjitura mjekësore, procesverbali i mbajtur pranë kësaj gjykate me dt.13.10.2009 në të cilin shqyrtim e kanë dhënë mendimin Dr.B. K. neurokirurg dhe Dr.N. Sh. neurolog, procesverbali i dt.21.12.2009 në të cilin shqyrtim përfaqësuesi i autorizuar i paditësve ka bërë riprecizimin e kërkesëpadiisë, dhe shkresat e tjera të lëndes.

Pas vlerësimit me kujdes dhe me ndërgjegje të secilës provë veç e veç dhe të gjithave bashkarisht e në pajtim me dispozitat e nenit 8 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, kjo Gjykatë lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko – civile vërtetoi se :

- Në bazë të Raportit të Shërbimit Policor të Kosovës me nr. të rastit 07 AR 01334 dt.10.08.2007 u vërtetua se me dt.10.08.2007 ka ndodhur aksidenti trafiku në të cilin aksident Paditësit kanë pësuar lëndime trupore;

- në bazë të ekspertizes së dt.16.05.2008 e përpiluar nga ing. Rr.S. është konstatuar se “ ... lëshimet e drejtuesit të automjetit Golf 2, janë lëshime teknike dhe në lidhje direkte me shkaktimin e këtij aksidenti “ ;

- Në bazë të deklarimeve të thëna në seancen e dt.16.05.2013, përfaqësuesi i autorizuar i të Paditësve i ka ofruar Paditësve një ofertë për paditësin e mitur G. A. në shumë prej 21.000,00 Euro, ndërsa për paditësen e mitur V. A. i shumë prej 5.000,00 Euro për të gjitha format e demit dhe këto oferta i ka të bazuara në 70 % nga baza e përgjegjësisë, dhe 30 % në emër të bashkëpërgjegjësisë të cilën e kanë të miturit, të cilën ofertë përfaqësuesi i autorizuar i të Paditësve nuk e ka pranuar ;

Në rastin konkret Gjykata mendimet e ekspertve ia dha besimin e plotë dhe i miratoj në tërësi ekspertizat e kryera të cilat kanë elemente të mjaftueshme dhe të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale për vërtetimin e kesaj çështje kontestimore dhe atë ;

- Ekspertizës të bërë nga eksperti mjekësor dr. Xh. S., ortopedë e dt.20.07.2008 i cili ndër të tjera ka konstatuar se Paditësi G. A. në aksidentin e përjetuar ka pësuar : *Ndrydhje të pjesës zverkore të kokës dhe të trurit me humbje humbje të vetëdijes dhe gjakderdhjes brenda – trupore me thyerje të kockës së kofshës së djathtë e shoqëruar me shtangime të ekstretimëve të sipërme.*

*Aktualisht ka : Hemiparezë diskrete të majtë; të ecur të shtrembëruar; të folur të ngadalsuar dhe të turbullt, vonesë në artikulum gjatë të folurit; mungesë e koncentrimit dhe shprehje të çrregullta mendimesh; shkrim i keq me gabime dhe kryeneq në veprimet e veta.*

Po ashtu ka konstatuar se Lëndimi karakterizohet si *lëndim i rëndë trupor i cili ka shkaktuar dhimbje fizike me llojet e intensiteteve të dhëna në ekspertizë, si dhe ndër të tjera ka konstatuar se te Paditësi G. A. :*

*“...Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është i shprehur në shkallën prej 60%...”*

Ndërsa për Paditësen V. A. eksperti mjekësor dr. Xh. S., ortoped në bazë të ekspertizës të bërë të dt.20.07.2008 i cili ndër të tjera ka konstatuar se Paditësja V. A. në aksidentin e përjetuar ka pësuar:

*“ Thyerje të dyfishtë të nofullës në regj. E trupit të sajë – djathtas me dislokim të fragmenteve dhe këndit të nofullës, ndërsa majtas pa dislokim si dhe plagë prerëse dërmishëse nën mjekërr prej 5 cm dhe në skajin e sipërm të buzës së sipërme djathtas.*

Lëndimi karakterizohet si *lëndim i rëndë trupor i cili ka shkaktuar dhimbje fizike*

*me llojet e intensiteteve të dhëna në ekspertizë, si dhe ndër të tjera ka konstatuar se te Padiësja V. A. :*

*“...Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është i shprehur në shkallën prej 10 %...”*

- Mendimit të dhënë nga eksperti mjekësor dr. B. K., neurokirurg, në shqyrtimin kryesor të dt.13.10.2009, i cili ndër të tjera ka konstatua se Padiësi G. A. në aksidentin e dt.10.08.2007 ka pësuar këto lëndime : *“Politraum, gjakderdhje në mes të cipave trupore, ndrydhje me gjakderdhje të indit trunor, ndrydhje të regjionit zverkor, thyerje e mbigjurit ( ose qapokut), të anës së djathtë të cilat lëndime karakterizohen si lëndime të rënda trupore dhe në momentin e shkakimit të aksidentit dhembje fizike me intenzitet posaqërisht të rëndë ...”*

Si dhe ndër të tjera ka konstatuar dhe ka dhënë mendimin se te Padiësi G. A. :

*“ Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor duke marrë parasysh shkallën e dëmtimit trupor të përshkruar më lartë, si dhe deficitet e konstatuara nerologjike që janë rrjedhojë e dëmtimit të indit trunor kapin vlerën 60 %...”*

- Mendimit dhe konstatimit nga ana e neuropsikiatrit ass. Dr.F. D. i cili pas ekzaminimit të shkresave të lëndes në ekspertizen e dt. 15.03.2013 ndër të tjera ka konstatuar se te Padiësi G. A. *frika sekondare e intensitetit të lartë ka zgjatur për 14 ditë, frikë sekondare të një intensiteti më të ulët edhe tani edhe në vazhdim sa herë që ballafaqohet me realitetin se ai është me shumë dëmtime në sferen psikike dhe fizike.*

Ndërsa për padiësen V. A. *frika sekondare e intensitetit të lartë ka zgjatur për 3 ditë, frikë sekondare të një intensiteti më të ulët e cila është prezente edhe sot, do të zgjat edhe për një kohë të ardhme d.m.th aktivizohet sa here që i bie në mend dhe psikikisht e pengon shenja në fytyrë.*

Ndërsa sa i përket dhimbjeve shpirtërore për B. A. dhe Sh. A. prindërit e G. A., Eksperti mjekësor Dr. F. D., në ekspertizen e dt.15.03.2013 ka konstatuar se : *“... dhimbja shpirtërore (vuajtje) e intensitetit të lartë ka qenë prezente një vit “*

*Kurse dhimbje shpirtërore e intensitetit të ulët herë herë edhe mesatare edhe sot e kësaj dite dhe në vazhdim për shumë e më radhë.*

- Mendimit nga ana e neuropsikiatrit ass. Dr.F. D., lidhur me shëmtimin për të miturin G. A. dt.02.05.2013.

- Sa i përket bazës, në bazë të deklarimeve të thëna në seancen e dt.16.05.2013, përfaqësuesi i autorizuar i të Padiësve i ka ofruar Padiësve një ofertë për padiësin e mitur G. A. në shumë prej 21.000,00 Euro, ndërsa për padiësen e mitur V. A. shumë prej 5.000,00 Euro për të gjitha format e demit dhe këto oferta i ka të bazuara në 70 % nga baza e përgjegjësisë, dhe 30 % në emër të bashkëpërgjegjësisë të cilën e kanë të miturit, të cilën ofertë përfaqësuesi i autorizuar i të Padiësve nuk e ka pranuar ;

-- Po ashtu në lidhje me bazën juridike, edhe përfaqësuesi i autorizuar i Padiësve në seancen e dt.16.05.2013, ka shtuar se kërkespadija e padiësve është e

bazuar me 70% të përgjegjesisë së të paditues, dhe 30 % lëshimeve të përgjegjesisë nga ana e Paditësve të mitur.

Andaj në bazë të deklaratave të dhëna nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese baza juridike si e tillë, por dhe e njëjta vërtetohet në provat që janë në shkresat e lëndës.

Kontestuese mbetet vetëm lartësia e dëmit e precizuar nga i autorizuari i paditësit.

Lidhur me lartësit dhe shumat aprovuara për shpërblimin e dëmit material dhe jo material për Paditësit G. A., dhe V. A. të përmendura sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi janë aprovuar bazuar në nenin 200 të Ligjit mbi Mardhëniet Detyrimore si dhe me rastin e caktimit të lartësisë së dëmit kjo gjykatë pati në konsiderim të gjitha rrethanat që ndikojnë në përcaktimin e tij, intensitetin e dhimbjeve, kohëzgjatjen e tyre, intensitetin e frikes, moshën e paditësve, dhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, dhe shumat e caktuara do të ofrojnë satisfacion të duhur për dhimbjet e përjetuara dhe do të ndikojnë në vënjen e barazpeshës psikike dhe emocionale duke i refuzuar për tej pjesës së gjykuar shumat që në parashtresë i ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i Paditësve duke u bazuar në atë që shumat e aprovuara të mos i shkojnë përshtati synimeve të njëjës palë për fitim pa bazë dhe kundër interesit të përgjithshëm shoqëror, por njëkohësisht pa e dëmtuar atë si pale, po ashtu duke marrë për bazë edhe 30 % e lëshimeve të përgjegjesisë nga ana e Paditësve të mitur.

Lidhur me shumat e aprovuara për Paditësit B. dhe Sh. A. Prindërit e Paditësit të mitur G. A., Gjykata vendosi konform nenit 201 të Ligjit mbi mardhëniet e detyrimeve.

Kërkesat për ndihmë të huaj dhe kërkesa për shëmtim për paditësen e mitur V. A. u refuzuan si të pabazuara në mungesë të provave .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore Gjykata u bazua në nenin 452.2 par.2 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe Tarifes së Odes së Avokatëve ku janë përfshirë shpenzimet në shumë prej 1.929 €uro në bazë të Aktgjykimit C.nr.325/2007, si dhe shpenzimet për përfaqësime në 3 seanca gjyqësore në shumë prej 540 €uro, për shpenzime të ekspertit Dr. F. D., psikiater shumë prej 120 €.

Prandaj, nisur nga të lartcekurat dhe duke ju referuar nenit/eve 185, 200, 201 të Ligjit mbi mardhëniet e detyrimeve dhe konform nenit/eve 4, 5, 7, 8 10, 321, 323 147.1, 452 dhe dispozitave tjera të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, dhe konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ nr.2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEGA NË PODUJEVË**  
**C.nr.422/12 datë 16.05.2013**

**Gjyqtari,**

**Bujar Muzaqi**

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij Aktgjykimi lejohet ankesa në afatin prej 15 ditësh,nga dita e marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.